

# Buletini

- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnineve të Vazhdueshme (PTV)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnineve Fillestare (PTF)
- \* Aktivitetet Tjera

Janar, 2017

## Aktivitetet nga Programi i Trajnoneve të Vazhdueshme

### Shqyrtimi Fillesstar, Shqyrtimi i Dytë dhe Shqyrtimi Gjyqësor

Më 18 janar 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të Programit të Trajnoneve të Vazhdueshme (PTV), ka realizuar trajnimin me temë “Shqyrtimi Fillesstar, Shqyrtimi i Dytë dhe Shqyrtimi Gjyqësor”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njo-hurive të pjesëmarrësve lidhur me procedurën penale që zhvillohet pas ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorit dhe shtjellimi i dispozitave të KPP- së të cilat rregullojnë zhvillimin e shqyrtimit fillesstar, shqyrtimit të dytë dhe shqyrtimit gjyqësor në funksion të zbatimit në mënyrë efikase të procedurës në këto fazë.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtua shqyrtimi fillesstar dhe shqyrtimi i dytë, afatet e caktimit të shqyrtimit fillesstar pas pranimit të aktakuzës dhe shqyrtimit të dytë, veprimet e kryetarit të trupit gjykues apo gjyqtarit të vetëm gjykues dhe rrjedha e shqyrtimit fillesstar dhe shqyrtimit të dytë, pjesëmarrësit në shqyrtimin fillesstar dhe të dytë dhe veprimet mes shqyrtimit fillesstar dhe shqyrtimit të dytë.

Gjithashtu u elaboruan kriteret me rastin e pranimit të fajësisë, opzionet pas pranimit të fa -

jësisë dhe rastet e veçimit të procedurës kur ka më shumë të pandehur dhe disa prej tyre e pranojnë fajësinë në shqyrtimin fillesstar e disa të tjerë jo.

Më tej, u diskutua për kundërshtimin e provave, përgjigja dhe vendimet në këto kundërshtime si dhe kërkesa dhe rr Ethanat e hudhjes së aktakuzës në këtë fazë.

Po ashtu trajnimi u fokusua edhe në trajtimin e shqyrtimit gjyqësor, si një ndër fazat më të rëndësishme të procedurës penale, fazat e shqyrtimit gjyqësor, detyrat dhe veprimet e kryetarit të trupit gjykues apo gjyqtarit të vetëm gjykues në shqyrtimin gjyqësor, si dhe ndërprerja dhe shtyrja e shqyrtimit gjyqësor.

Po ashtu u elaborua administrimi i provave, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe të akuzuarve, si dhe afati dhe përfundimin e shqyrtimit gjyqësor.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



## “Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore - Nenet 2,3,4,5,6 dhe 7”

Nga 18-21 janar 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Shtetit – Zyra Tej-oceanike për Zhvillim të Prokurorisë, Ndihmë dhe Trajnim (OPDAT), Departamenti Amerikan i Drejtësisë-Zyra Ndërkombëtare për Narkotik dhe Zbatim të Ligjit, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme organizoi trajnimin “Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore - Nenet 2,3,4,5,6 dhe 7”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me rëndësinë e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe efektit të saj në sistemin juridik të shteteve nacionale veçmas të Republikës së Kosovës.

Në fokus të trajnimit ishte analizimi i dispozitave të nenit 2,3,4,5,6,7 të KEDNJ.

Konkretnisht u elaborua natyra, rëndësia, efekti dhe fushëveprimi i të drejtës për jetë, nga këndvështrimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, tortura, tra-

jtimi çnjerëzor, degradimi apo dënim, arrestimi i ligjshëm, procedurat urgjente dhe të drejtat e personit të paraburgosur dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ, si dhe e drejta për një proces të rregullt dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ në këtë lëmi.

Me rëndësi ishte edhe analiza e dispozitave të nenit 7 të KEDNJ – mbi të drejtën se “Nuk ka dënim pa ligj”, më konkretisht – standardet dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ nga ky aspekt.

Përmes diskutimeve dhe shembujve studimor u elaboruan të drejtat e lartpërmendura në KEDNJ dhe vendimet e rëndësishme të jurisprudencës së GJEDNJ e që janë me vlerë obligative për gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Kosovës.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë të gjykatave në të gjitha nivelet, prokurorë, dhe avokatë nga radhët e OAK. Themelore.



## Seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës

Më 20 janar 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të PTV, ka realizuar trajnimin me temë “Seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me seancën përgatitore, shqyrtimin kryesor dhe marrjen e provës.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan kushtet për mbajtjen e seancës përgatitore, thirrja për këtë seancë, mbajtja e saj, shqyrtimi kryesor - kushtet për mbajtjen e tij, procedura e të provuarit dhe marrja e provave, etj.

Gjithanshëm u trajtua aspekti teorik dhe ai praktik që ka të bëjë me seancën përgatitore, shqyrtimin kryesor dhe marrjen e provës, si faza të

veçanta të procedurës kontestimore.

Në hollësi u svaruan dilemat të cilat po i përcjellin gjyqtarët, se si duhet të veprohet në seancën përgatitore, shqyrtimin kryesor dhe marrjen e provës në kuptim të dispozitave të LPK-së.

Në trajnim u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshire shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik, ku pjesëmarrësit ishin aktiv gjatë gjithë kohës, duke marrë pjesë në diskutime me prezantuesin pas çdo shpjegimi.

Përfitues ishin gjyqtarët e divizioneve civile të departamenteve të përgjithshme në gjykatat themelore.



## Mundësia hetuese e veçantë

Më 25 janar 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka realizuar trajnimin me temë “Mundësia hetuese e veçantë”

Synimi i trajnimit ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me procedurën penale që zhvillohet kur kemi të bëjmë me zbatimin sa më të suksesshëm të dispozitave ligjore që rregullojnë çështjen e institutit juridik të mundësisë së veçantë hetuese.

Gjatë trajnimit u trajtua mundësia hetuese e veçantë si kontribues në tejkalimin e paqartësive që ekzistojnë në praktikën gjyqësore si në çështjet e marresës në pyetje të palëve në procedurë dhe në analizimin e rasteve kur dëshmja e marr në hetimet e veçanta është provë e pranue-

shme për gjykaten, në të cilën mund të bazohet aktgjykimi.

Përveç kësaj, u trajtuan edhe provat, shqyrtimi dhe pranueshmëria e provave të siguruar nga mundësia hetuese e veçantë, si dhe përbërja e trupit gjykues në shqyrtimin e këtyre provave.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interakte, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



## Kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit të ri për kundërvajtje

Më 27 janar 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit të ri për kundërvajtje”.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte elaborimi i hollësishëm i dispozitave të Ligjit të ri për Kundërvajtje, njoftimi i pjesëmarrësve me kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksionet për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura për kundërvajtje, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje.

Çështjet të cilat janë trajtuar gjatë këtij sesioni trajnues kishin të bënин me përgjegjësitë kundërvajtëse, sanksionet kundërvajtëse dhe

masat e veçanta të kundërvajtjes.

Po ashtu u trajtua edhe parashkrimi i zhvillimit të procedurës së kundërvajtjes se si zhvillohet procedura sipas ligjit të ri për kundërvajtje.

Gjatë trajnimit u aplikua metoda e kombinuar e prezantimit, ku përmes shembujve praktik dhe diskutimeve interakteive gjyqtarëve pjesëmarrës ju ofruan alternativa për paqartësitë dhe vështirësitë e zbatimit ligjit të ri për kundërvajtje në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga gjykatat themelore - divizioni për kundërvajtje nga të gjitha Regionet e Kosovës.



## Aktivitetet nga Programi i Trajnoneve Fillestare (PTF)

### Aktivitetet e realizuara në PTF- janar 2017

Në muajin janar 2017, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për prokurorët e sapoemëruar, janë zhvilluar aktivitete trajnuese duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktikë.



Në kuadër të trajnimit teorik, në këtë periudhë janë realizuar gjithsej 14 sesione trajnimi për modulin “Kodi Penal i Kosovës”. Për pjesën e përgjithshme të Kodit Penal të Kosovës, janë realizuar 7 sesione trajnimi, ku janë shtjelluar vëç e veç elementet e veprave penale siç janë veprimi, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria me ligj, përgjegjësia penale etj.

Ndër të tjera u elaboruan edhe fazat e kryerjes së veprës penale, nocioni, sistemimi dhe karakteristikat kryesore të sanksioneve penale dhe ekzekutimit të tyre.

Ndërsa, për pjesën e veçantë të Kodit Penal të Kosovës, janë realizuar 7 sesione trajnimi,

duke u elaboruar në këtë formë disa nga: veprat penale nga kapitulli XX dhe XXIII, veprat penale nga kapitulli XXIII dhe XXV, veprat penale nga kapitulli XXVII dhe veprat penale nga kapitulli i XXIX.

Metodologjia e përdorur ishte e kombinuar gjatë realizimit të këtyre sesioneve trajnuese, duke përfshirë prezantime dhe diskutime interaktive, ku prokurorët e sapoemëruar ngriten çështje me interes dhe dilema të cilat po ashtu i vërejnë gjatë fazës praktike të trajnimit në prokuroritë përkatëse.

Përmes detyrave dhe ushtrimeve praktike, ata u angazhuan në përgatitjen dhe prezantimin e rasteve përsituata të ndryshme hipotetike.

Në kuadër të trajnimit praktikë në prokurori, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre.

Po ashtu në përbushje të programit trajnues, më datë 18 janar 2017 prokurorët e sapoemëruar kanë vijuar trajnimin praktikë në Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë.



## Trajinim praktik i prokurorëve të sapoemëruar në Qendrën për Punë Sociale

Më 18 janar 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për prokurorët e shtetit, të sapoemëruar, ka realizuar trajnimin praktikë në Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte që prokurorët e sapoemëruar të njoftohen me rolin, funksionin dhe përgjegjësit e Qendrës për Punë Sociale.

Fillimisht në kuadër të këtij trajnimi pasqyrua

një historiat i shkurtër i zhvillimit të Qendrës për Punë Sociale, struktura organizative dhe mënyra e funksionimit të saj.

Më tej, në mënyrë të hollësishme u shtjelluan kategoritë e klientëve që trajton QPS-ja dhe shërbimet që ajo ofron, si dhe vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet në përm bushjen e përgjegjësive të saj.

Prokurorët e sapoemëruar po ashtu kishin rastin që të njoftohen për së afërm me punën e QPS-së në Prishtinë, duke vizituar në këtë mënyrë ambientet dhe zyrtarët e QPS-së.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të shtetit, gjenerata e VI-të e PTF-së.



## Aktivitetet Tjera

### Takimi i Këshillit Programor të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Më 30 janar 2017, në Institutin Gjyqësor të Kosovës është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Programor të IGJK-së.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi dhe shqyrtimi i draft Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar 2017/2018, të cilët janë në proces të rekrutimit nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Anëtarët e Këshillit Programor diskutuan për strukturën dhe përbajtjen e Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarë, temat e përfshira në program, kohëzgjatjen e sesioneve të

trajnimit si dhe për çështje tjera të rëndësishme për zbatimin e këtij programi trajnues.

Këshilli Programor vlerësoi se draft-Programi për Trajnimin Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar 2017/2018 plotëson të gjitha kriteret e një programi të mirëfilltë, është mjaft profesional, i balancuar në pikëpamje të shpërndarjes së numrit të sesioneve nëpër të gjitha fushat e së drejtës dhe rekomanuan që ky program ti prezantohet Këshillit drejtues të IGJK-së për diskutim dhe miratim.

### Kontribut për bibliotekën e IGJK-së

Më 30 janar 2017, U.D Drejtori i Institutit Gjyqësor të Kosovës, pati kënaqësinë që të pres në një takim të përzemërt profesorin e nderuar Prof. Dr. Ejup Sahiti.

Në këtë takim u diskutua për rolin e Institutit Gjyqësor të Kosovës në ngritjen e kapaciteteve profesionale brenda sistemit gjyqësor në Kosovë, e veçanërisht për burimet ligjore që ofron Biblioteka e IGJK-së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë gjyqësor.

Prof. Dr. Ejup Sahiti, ka shprehur dëshirën që bibliotekës së IGJK-së t'i dhuroj disa nga

titujt e botuar nga puna e tij shkencore siç: Procedura penale, Psikologjia gjyqësore, Argumentimi në procedurën penale, Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurën penale, duke kontribuuar në pasurimin e bibliotekës së IGJK-së me tituj të ri nga fusha juridike.

U. D. Drejtori i IGJK-së z. Besim Morina falënderoi profesorin e nderuar për këto libra, por edhe për kontributin e dhënë për gjithë këto vite në cilësinë e ekspertit dhe anëtarit të Këshillit Programor në IGJK.



<https://igjk.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”  
Rr. Muharrem Fejza p.n  
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660  
Fax: + 381 38 512 095  
E-mail: infokji@rks-gov.net**